



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER**

*Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22*

**Nr. Rregj.Them. 290/1546**  
**Dt. Rregj. 30.10.2014**

**Nr. Vendimi 362**  
**Dt. Vendimi 05.05.2015**

**V E N D I M**  
**" Për mos pranim të padisë "**

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Albana Palaj, sot me datë 05.05.2015, ora 09.30 në kryerjen e veprimeve përgatitore të çështjes administrative me nr.Rregj.Them. 290/1546 datë 30.10.2014 që l përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Shoqeria "Arion" sh.p.k perfaqesuar nga administratori Agim Ruci,i biri i Riza-it dhe Fatime-s, datlindjes 21.02.1959, lindur dhe banues ne Shkoder, adresa per njoftim,cel. 0673214471.

**E PADITUR:** 1.Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane.  
2.Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e akteve administrative gjobat e vena nga Drejtoria Rajonale –e Tatimeve–Shkoder,Njoftim vleresimi tatimor me nr.118/2 prot., date 01.02.2011 te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, Njoftim vleresimi tatimor me ,nr.283/6 prot., date 16.01.2013,rap.kontr. nr.283/3 date 26.11.2012,proceverbalin e gjobes nr.3785/9 date 13.05.2010,njoftim kontrolli dhe gjobe nr.283 date 25.09.2012 (Akt konstatimi)nr.1,2,3,4,5 dhe 6,akt kontrolli dt.30.10.2012.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.Sh". K.Pr.Administrative, neni«116 e vijues. Nenet 31 e 32 te K.Pr.Civile. Ligjit 49/2014. "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" Nenet 12,45,56,106,108,109,115 dhe 118 te K.Pr.Administrative.

Gjykata kryesisht shqyrtton mbi kushtet e nenit 18 të ligjit 49/2012, mbi afatin e ngritjes së kërkesë padisë, dhe

**VEREN se:**

Paditesi Shogëria "Arion" sh.p.k, I është drejtuar Gjykates administrative shkalle e para Shkoder kunder anes se paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me objekt;

"shfuqizimin e akteve administrative gjrobat e vëna nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, njoftim vlerësimi tatimor **nr.118/2 prot datë 01.02.2011** të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, njoftim vlerësimi tatimor me **nr.283/6 prot datë 16.01.2013**, raport kontrolli nr.283/3 datë 26.11.2012, procesverbalin e gjobës nr.3785/9 datë 13.05.2010, **njoftim kontrolli dhe gjobë nr.283 datë 25.09.2012** (akt konstatimi) nr.1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe akt kontrolli datë 30.10.2012".

Gjykata ne lidhje me kerkimin e paditesit dhe provat e bashkangjitur kerkimit konstaton se :

Me njoftim-vlerësimin nr.3785/9 prot dt.13.05.2010 subjekti është njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me detyrime, gjobë në vlerën 100 000 lekë, për periudhën tatimore 2010/05 për "mospajse me kasë fiskale", në zbatim të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 122 pika 1, gërma (a / i).

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për Apelim, Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.8598/1 prot datë 21.06.2010 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

Lënien në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi, njoftim vlerësimit nr.3785/9 prot dt.13.05.2010 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Referuar objektit të kërkesë-padisë dhe datës së paraqitjes së kësaj kërkesë-padie në gjykatë, paditësi ka humbur afatin ligjor për t'ju drejtuar gjykatës.

Neni 18 i Ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" pika 1 shkronja (a) shpreh :

*Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në Gjykatë brenda 45 ditëve.*

Ky afat fillon nga :

a) data e njoftimit sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ...

*në nenin 72 pika (3) të ligji 49/2012 shprehet :*

*Të gjitha afatet për paraqitjen e padisë ndaj aktit apo veprimit tjetër administrative janë 45 ditë, me përjashtim të rasteve kur në ligjet e veçanta është parashikuar ndryshe.*

Referuar ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 109 pika (2) shpreh :

*tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.*

Prandaj ky lloj kerkimi nuk mund të pranohet tashmë nga gjykata, pasi është jashtë afatit ligjore 30 ditore te paraqitjes se kerkimit ne gjykate.

➤ Me njoftim-vlerësimin nr.118/2 prot dt.01.02.2011 subjekti është njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me detyrime, gjobë në vlerën 500 000 lekë, për periudhën



Estimore 2011/01 për "mospaisje me kasë fiskale", në zbatim të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 122 pika 1, gërma (a / ii).

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për Apelim, Drejtorisë së Apelimat Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.3835/2 prot datë 06.06.2011, subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

*Refuzimin e ankimit, pasi kërkesës ankimore i mungonte akti administrativ objekt ankimit.*

Pra referuar objektit të kërkesë-padisë dhe datës së paraqitjes së kësaj kërkesë-padie në gjykatë, paditësi ka humbur afatin ligjor për t'ju drejtuar gjykatës. Per njoftim vlerësimat tatimor nr.118/2 prot dt.01.02.2011 .

Në nenin 59 të Kodit të Proedurës Civile përcaktohet se :

*"Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ....."*

Neni 16 i Ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" pika 1 shpreh :

*1.Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.*

*Rezulton qe jo vetem kerkimi eshte jashte afatit ligjore konfrom 109 te ligjit 9920/2008 dhe 18, 73/2 te ligjit 49/2012 por dhe ne mos ezaurimin e kushteve te nenit 16 te ligjit 49/2012.*

➤ Përkatësisht me aktin, njoftim vlerësimin tatimor nr.283/6 prot datë 16.01.2013 subjekti është njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me detyrime tatimore shprehur në mënyrë të detajuar në këtë njoftim vlerësim, (pjesë e këtyre prapësimeve), sipas zërave përkatës tatimore dhe periudhave përkatëse tatimore.

Duke mos qenë dakort me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për Apelim, Drejtorisë së Apelimat Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr.3762/1 prot datë 09.04.2013, subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

*Refuzimin e ankimit për shkak se e konsideron atë të papranueshëm, pasi nuk është paguar detyrimi tatimor i përcaktuar në aktin administrativ objekt ankimit.*

**Së pari**, referuar datës së paraqitjes së kësaj kërkesë-padie në gjykatë, paditësi ka humbur afatin ligjor për t'ju drejtuar gjykatës.

Kërkesë-padia sipas shënimeve të gjykatës shprehur në të dhe komunikuar nga gjykata është paraqitur para saj me datën 30.10.2014. jashte cdo afati ligjore, per pasoje konfrom nenit 18 te Ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" pika 1 shkronja (a) shpreh :

*Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në Gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga :*

*a)data e njoftimit sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ...*

*Po në nenin 72 pika (3) të këtij ligji shprehet :*

*Të gjitha afatet për paraqitjen e padisë ndaj aktit apo veprimit tjetër administrative janë 45 ditë, me përjashtim të rasteve kur në ligjet e veçanta është parashikuar ndryshe.*

Referuar ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 109 pika (2) shpreh :

*tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.*

Neni 106 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në RSH-së" i ndryshuar, "Objekti i ankimit administrativ tatimor" shpreh :

- *Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.*

- *Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.*

- *Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në Drejtorinë e Apelimit Tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.*

Neni 107 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar shpreh :

*Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi*

*1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.*

*2. Shuma e pagueshme ose suma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjokat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.*

*3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni. (Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.203, datë 30.12.2013)*

*Subjekti nuk ka paguar detyrimin pasqyruar në këtë njoftim vlerësim duke marrë në konsideratë rregullimin e sipërpërmendur që kërkon ligji.*

***4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.***

Neni 16 i Ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" pika 1 shpreh :

***1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.***

Drejtoria e Apelimit Tatimor duke refuzuar kërkesën ankimore të subjektit nuk ka shqyrtuar në thelb çështjen.

Pra pala paditëse nuk ka ezauruar rrugën administrative të shqyrtimit të çështjes, mosmarrëveshja objekt gjykimi është jashtë juridiksionit gjyqësor për këtë pjesë të kërimit të palës paditëse.

Në nenin 59 të Kodit të Proçedurës Civile përcaktohet se :

*"Gjykata në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, qoftë edhe kryesisht merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo administrativ....."*

*Referuar dhe nenit 39 të ligjit 49/2012 .*

### **Vendimet jopërfundimtare**

1. Gjykata administrative jep vendime jopërfundimtare vetëm në rastin e mospranimit të padisë dhe të pushimit të gjykimit.

2. Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave.

Nga sa me sipër arsyeton, gjykata vleron se padia për shkak të mos plotësimit të kushtit formal të ngritjes në afat, sipas nenit 18, 16,39 të ligjit 49/2012, vendose mospranimin e padisë, si padi e ngritur jashtë kushteve ligjore të analizuara me sipër, prandaj

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata konform nenit 18 pika 5,7 dhe 39/2 të ligjit 49/2012

### **VENDOSI**


Mos pranimin e padisë.

Shpenzimet gjyqësore sic janë bere.

Kundër vendimit lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**Shkodër me datë 05.05.2015**

**SEKRETARE SEANCE**  
**Albana PALAJ**



**GJYQTARE**  
**Valbona DURRAJ**

**VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË**

**SOT ME DATË 08.09.2015**

